



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.100/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kandidatit për kryetar të Komunës së Deçanit nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Jeton Mushkolaj, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.100/2025, e datës 03.10.2025.
- II. Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 2,000.00 (dy mijë) Euro.
- III. Detyrohet subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 03.10.2025 PZAP ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se me datë 03.10.2025 gjatë orarit të punës, kandidati për kryetar të Komunës së Deçanit nga radhët e LDK-së, z. Jeton Mushkolaj, ka realizuar një vizitë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare "Adem Ukehaxhaj". Vizita është shoqëruar me publikim të fotografive dhe një deklaratë në rrjete sociale, ku theksohet qartë se bëhet fjalë për aktivitet të lidhur me fushatën elektorale. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 34 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili ndalon shfrytëzimin e hapësirave dhe resurseve publike për qëllime të fushatës zgjedhore, si dhe me

nenin 6 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, që ndalon përdorimin e infrastrukturës dhe pasurive publike nga kandidatët apo subjektet politike gjatë fushatës.

Provë ka bashkangjitur postimin publik të kandidat për kryetar të Komunës së Deçanit, Jeton Mushkolaj në rrjetin social Facebook, me fotografi të vizitës në QKMF gjatë orarit të punës.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës ka deklaruar se vizita e z. Mushkolaj është zhvilluar gjatë kohës së pauzës së drekës, një periudhë e rregullt e përcaktuar për stafin shëndetësor dhe administrativ të QKMF-së. Kjo do të thotë se në asnjë moment nuk është cenuar ofrimi i shërbimeve për qytetarët dhe as nuk është ndërprerë procesi i punës së zakonshme. Vizita ishte e shkurtër, pa penguar punonjësit në detyrat e tyre dhe pa shkaktuar ndonjë vonesë apo shqetësim për pacientët. Gjithashtu, është me rëndësi të theksohet se kandidati nuk ka shfrytëzuar hapësirat apo resurset publike për aktivitete të natyrës partiake, por thjesht ka zhvilluar një vizitë informuese dhe miqësore në një institucion publik. Vizita nuk ka pasur karakter të organizuar për fushatë brenda institucionit, por është pasqyruar vetëm më vonë në rrjete sociale si pjesë e komunikimit politik të zakonshëm. Nuk ekziston asnjë dëshmi se kjo vizitë ka ndikuar negativisht në punën e QKMF-së ose ka sjellë ndonjë favorizim apo shfrytëzim të padrejtë të pozitës publike, LDK ka qenë aty në kohën e drekës (fiks në ora 09:45), të bashkangjitur e keni edhe pauzën (foto), si dhe kemi njoftuar drejtorin e qendrës dhe na ka lajmëruar për pauzën dhe postimi është postuar në kohën e drekës. LDK aktualisht gjendet në opozitë, prandaj vizita është konsideruar më tepër si një aktivitet politik i zakonshëm dhe jo pjesë e një agjende zyrtare institucionale. Ajo është zhvilluar jashtë orarit të punës dhe nuk ka qenë pjesë e ndonjë procesi qeveritar apo detyrimi zyrtar. Duke qenë parti opozitare, LDK ka të drejtë të organizojë aktivitete të tilla politike për të komunikuar me qytetarët dhe për të shprehur qëndrimet e saj politike pa lidhur drejtpërdrejt me obligimet e institucioneve shtetërore. Në këtë rast, siç dëshmohet qartë, aktiviteti është zhvilluar jashtë orarit aktiv të punës, pra gjatë kohës së pauzës, dhe rrjedhimisht nuk ka elemente të ndonjë shkelje ligjore.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

- Ankesa është bazuar

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore dhe përgjigjen në ankesë, ka gjetur se postimi i fotografive në rrjetin social facebook, nga kandidatit për kryetar të Komunës së Deçanit nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Jeton Mushkolaj, është vërtetuar se ka vizituar dhe zhvilluar një takim me punonjës të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Adem Ukehaxhaj”. Nga prova materiale e bashkangjitur ankesës, së Subjektit Politik LVV, dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se nga ana e kandidatit për kryetar nga radhët e subjektit politik LDK, është shkelur dispozita ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme LZZP, konkretisht neni 36 paragrafi 1, 2, dhe 3, i cili përcakton: *“1. Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e*

asnje institucioni te administrates publike, qofte te nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonje ndermarrjeje ne zoterim ose te kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund te shfrytezohen ose te futen ne mbeshtetje te ndonje subjekti politik ne zgjedhje 2. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnje subjekt politik nuk inkurajon ose perfiton nga nepumes i publik duke perdorur pozitën publike te tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik 3. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të subjekteve politike në zgjedhje, burime ose resurse të institucioneve apo organeve publike në nivel qendror ose lokal, apo çdo lloj institucioni tjetër publik”

Përveç kësaj, me nenin 5 par 2, pika 2.1 Rregulla Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, është përcaktuar se: “2. Në fushatën e zgjedhjeve, nuk mund të përfshihen kategoritë e personave, si në vijim: 2.1. Të punësuarit në institucionet shtetërore dhe publike, gjatë orarit të rregullt të punës, përveç kandidatëve të certifikuar, të cilët pezullojnë vendin e punës”. PZAP vlerëson se kandidati për kryetar të komunës së Deçanit, Jeton Mushkolaj ka shkel rregullat e sipërcituara kjo pasi që ka përdorë objektin publik dhe të punësuarit e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Adem Ukehaxhaj” me qëllim të promovimit të kandidaturës së tij për kandidat për kryetar.

Gjithashtu Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën përsëritje të shkeljes së legjislacionit zgjedhor të kësaj natyre. Kjo konsiston në faktin se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e fotografisë në rrjetin social facebook nga kandidati për kryetar, për fushatë zgjedhore ku është shfrytëzuar objekti publik dhe takimi me punonjës shëndetësor, është në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 36 paragrafi 1, 2, dhe 3 të Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 neni paragrafi 1.3 të Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.100/2025, më datën 06.10.2025.

Kryesuesi i Panelit
Ramush Bardhi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën E Kosovës.